

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, -Departamenti i Përgjithshëm-** përmes gjyqtarit Behar Ymeri, me sekretaren juridike Igballe Azemi në lëndën penale kundër të pandehurit L.m R me vendbanim në fshatin L i E K.Gj me mbrojtësin me autorizim av... nga Gj, për shkak të veprës penale Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 paragrafi 6 lidhur me paragrafin.1 të KPRK-s. sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan- Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.7/2016, të datës 12.01.2016, të cilin e përfaqëson Prokurori Kujtesa Fazliu, pas mbajtjes së shqyrtimit, mbi pranimin e marrëveshjes së fajësisë dhe të sanksionit penal, në prezencën e prokurorit të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, më datën 10.05.2017, mori dhe në prezencë të palëve shpalli këtë,

## **A K T G J Y K I M**

I Pandehuri **L.R**, nga i ati A, e ëma Q, e lindur I, i lindur më dt..., në fshatin N, K.B, tani me vendbanim në fshatin L i E K.Gj, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar- baba i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, më parë i pa dënuar dhe nuk udhëheqet procedurë për veprë tjetër penale .

### **Ë s h t ë f a j t o r**

Sepse më datë 16.12.2015, rreth orës 10:00 min, në Gjilan, derisa I pandehuri e kishte parkuar automjetin e tij kombi të markës “Ford” me tabela të regjistrimit..., e të cilin nuk e kishte siguruar – duke mos e ngre frenin e dorës, ashtu që automjeti kishte lëvizur dhe kishte arritur në rrugën “...” ku në afërsi të bazës taxi “...” e kishte goditur automjetin e parkuar të markës “..” me tabela të regjistrimit 06-382-be, prone e të dëmtuarit M. I, e më pas kishte vazhduar të lëviz dhe e kishte goditur automjetin e parkuar të markës “..” me tabela të regjistrimit..., prone e të dëmtuarës N. B, me ç’rast tani të dëmtuarve të lartcekur u ka shkaktuar dëme në vlerë të pa përcaktuar.

-me çka ka kryer veprën penale Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata duke iu referuar marrëveshjes së arritur me shkrim mbi pranimin e fajësisë të akuzuarit, në bazë të neneve 4, 41, 46, 73 dhe 75 të KPRK-s dhe nenit 233 dhe 365 të KPPRK-s.

## **E G J Y K O N**

Të akuzuarit L. R i shqiptohet denimi me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) euro, të cilin denim do ta paguaj në afat prej 30 ditë, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari refuzon që të paguajnë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguajë atë, atëherë dënimin me gjobë me pajtimin e të pandehurit mund të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme. Nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimin me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë dënimin me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € të dënimin me gjobë do të caktohet nga një ditë burgim. Palët e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohen në kontest civil.

Obligohet i pandehuri të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipsas llogarisë përfundimtare të gjykatës, si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20 (njëzetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcnim të përmbarimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Kundër të pandehurit në fjalë është ngritur akti akuzues lëndor për shkak të dyshimit të bazuar se i njejt i ka kryer veprën penale lëndore të përshkruar më gjërë si në pikpamje faktike ashtu edhe juridike në vet aktin e tillë shkresor dhe ka propozuar që pas mbajtjes së séances

gjqësore dhe shtjellimit të provave të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta denoj me denim meritor sipas ligjit.

Prokurori i shtetit Kujtesa Fazliu deklaroi: Pas negociimit për marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, më dt.04.04.2017, kemi arritur marrëveshje, mbi pranimin e fajësisë me të pandehurin, ku i njëjti është pajtuar që të pranojë fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, dhe atë gjithnjë në pjesëmarrje dhe konsultim me mbrojtësin e tij. Prandaj, bazuar në këtë kërkojmë nga gjykata që konform nenit 233 par.21 të KP që këtë marrëveshje ta aprovojë.

Mbrojtësi i të pandehurit me autorizim av. ...deklaroi: është e vërtetë që me dt. 04.04.2017, me prokurorin e shtetit kemi negociuar marrëveshjen dhe jemi pajtuar bashkërisht duke marrë pjesë edhe i pandehuri për të gjitha pikat të cilat janë të cekura në marrëveshje, andaj gjykatës i propozoj që të njëjtën ta aprovojë.

I pandehuri, deklaroi: e mbështes në tërësi deklaratën e mbrojtësit tim, dhe deklaroi se nuk ka tjetër se çka të shtoj.

Marveshja për pranimin e fajësisë përmbante të gjitha faktet duke bërë propozim për marrëveshjen e pranimit të fajësisë duke e njoftuar të akuzuarin me të drejtat dhe pasojat e pranimit të fajësisë duke dhënë deklaratë me shkrim, se e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, të bërë në mënyrë vullnetare.

Gjykata ka gjetur se i pandehuri ka bërë marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe sanksionit penal mbështetur në nenin 233 të KPPRK, dhe e njëjta marrëveshje ishte në përputhje me kushtet e parapara me pikën 12 të këtij neni.

Gjykata është vërtetuar se i pandehuri e ka kryer veprën penale e cila i vëhet në barrë dhe ka konstatuar se nuk ekziston asnjë përjashtim si në nenin 248 të KPPRK.

Në seancën për pranimin e fajësisë përfaqësuesi i akuzës i pandehuri dhe mbrojtësit i tij janë marrë vesh edhe lidhur me sanksionin penal, ashtu që ti shqiptohet denim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) euro, të cilin denim do ta paguaj në afat prej 30 ditë, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Bazuar në nenin 453 të KPPRK-ës Gjykata e obligoi të pandehurin që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në contest civil. Përfaqësuesi i akuzës, I pandehuri dhe mbrojtësi i të pandehurit me autorizim kanë hequr dorë nga e drejta në ankesë. Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**  
**P.nr. 126/16 të datës 10.05.2017**

**Sek. Juridike,**  
**Igballe Azemi d.v**

**Gjykatësi i vetëm gjykes,**  
**Behar Ymeri d.v**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Ky aktgjykim është i plotëfuqishëm ditën e shpalljes së aktgjykimit në pajtim me nenin 233 par.12 pika 1, dhe pika 3.të KPPRK-ës.